



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:

Fondi për Sigurim Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2021.

Qëllimi i revizionit:

Të fitoet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht, dhe nëse aktivitetet dhe transaksionet janë në paitim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- Dobësi në zbatimin e kontrolleve të brendshme dhe në terren gjatë konfirmimit të objektivitetit të ndërhyrjeve të faturuara.
- Dobësi në kontrollet gjatë shkruarjes dhe dhënies së barnave.
- Mosrespektim i afateve gjatë kryerjes së kontrolleve dhe shqiptimit të dënimeve kontraktuese.
- Për shkak mos vendosjes së kontrollit janë paguar kompensime për pushime shëndetësore edhe kur personat e siguruar kanë marrë pagë.
- Dobësi gjatë përcaktimit dhe kontrollit të realizimit të kompensimit me kusht të ISHP-së

Mendimi i dhënë *:

Shprehëm mendim me rezervë në bazë të së vërtetës dhe objektivitetit të raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante për vitin 2021.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Për tri vite, nga qytetarët në shëndetësinë private, vetëm për PCR teste, më së paku kanë hyrë 19,9 milion euro.
Nuk është azhurnuar lista e barnave të cilat bien në barrë të Fondit.
Në vitin 2021 është realizuar vëllim dukshëm më të ulët të shërbimeve në lidhje me kompensimin e kontraktuar, për shkak 106 nga gjithsej 116 ISHP kanë marrë statusin e paqëndrueshëm.

Rekomandimet kyçe:

- Vendosjen e sistemit të planifikimit, monitorimit dhe kryerjen e kontrollit të rregullt të llojit dhe vëllimit të kryerjes së shërbimeve shëndetësore dhe recetave të lëshuara.
- Rregullimi i procedurës dhe vendosjen e kontrollit gjatë pagesës së kompensimeve për pushimet shëndetësore.
- Forcimi i kontrolleve të kompensimi me kusht.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Është marrë njoftim për draft-raportin gjatë së cilës është konstatuar se paraqet sqarimi/njoftimi në bazë të gjendjeve të përcaktuara.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Përgjigjja e vërejtjeve është dhënë në bashkëngjitje të Raportit Përfundimtar të revizorit të autorizuar shtetëror.

* pozitive, me rezervë, të pavolitshëm, të përmbajtur